



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

POSTA SHQIPTARE SH.A

Nr. _____ prot.
më _____.____.2020

Tiranë,

Lënda: Njoftim modifikimesh dhe shtyrje afati hapje procedure prokurimi.

AGJENCISË SË PROKURIMEVE PUBLIKE
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Këshilli i Ministrave.

Autoriteti Kontraktor “Posta Shqiptare” sh.a. ka hapur procedurën e prokurimit **REF-54681-03-19-2020** me objekt: “**Mirëmbajtja e Sistemit Eterna për tre vite**”, me fond limit **27.000.000 (Njëzet e shtatë milion) Lekë**, pa TVSH, me procedure ”E hapur” me mjete elektronike, e planifikuar për tu zhvilluar me datë 17/04/2020, Ora: 10:00 dhe e pezulluar në zbatimi të Njoftimit Nr.2371 Prot., datë 31.03.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik “*Për pezullimin e shpalljes së procedurave të reja të prokurimit publik, si dhe atyre që janë në proces*”, për vitin 2020, në kuadër të situatës së shkaktuar nga pandemia Covid 19.

Në vijim të sqarimit të APP-së, se autoritetet kontraktore mund të vijojnë procesin e prokurimit (shpalljet e reja apo procedurat që janë në proces) për mbulimin e nevojave të dala në kuadër të situatës së shkaktuar nga pandemia Covid 19, dhe për ato objekte që janë të domosdoshme për mbarrëvajtjen e punës së autoriteteve kontraktore, duke përfshirë objektet e prokurimit të lidhura me ofrimin e shërbimeve për komunitetin, si dhe nisur nga domosdoshmeria për vijimësinë e ofrimit të këtij shërbimi më qellim mbajtjen në funksion të **Sistemit Eterna**, pasi mungesa e një kontrate për mbulimin me këtë shërbim, do të vinte në rrezik vazhdimin e shërbimeve financiare dhe postare në rast defekti dhe për rrjedhojë shkaktimin e një dëmi të madh ekonomik për shoqërinë “Posta Shqiptare” sh.a., **heqim nga pezullimi** procedurën e prokurimit **REF-54681-03-19-2020** me objekt: “**Mirëmbajtja e Sistemit Eterna për tre vite**”, duke vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

Adresa: Rr.“Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë, Tel: 042222315, Kodi Postar 1001, www.postashqiptare.al

faqe 1

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor në mbështetje të nenit 42 të Ligjit 9643 “Për Prokurimet Publike” (me ndryshimet), përgatiti modifikimin e njoftimit të kontratës, duke shtyrë me 5 (pesë) ditë afatin për dorëzimin dhe hapjen e ofertave si vijon:

- Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje ishte **17/04/2020, Ora: 10:00 bëhet data 05.05.2020, ora 10.00.**
- Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje ishte **17/04/2020, Ora: 10:00 bëhet data 05.05.2020, ora 10.00.**

Kjo shtojcë e kriterit të modifikuar bëhet pjesë e dokumentacionit standart të tenderit. Dokumentat e tjera të procedurës së prokurimit ngelen të pandryshuara.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Laert Duraj